



KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



NPL "EKO-THERANDA"
SH.A. SUHAREKË

RAPORT I PUNËS

Periudha:

01 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025

Ndërmarrja Publike Lokale "EKO-THERANDA"

07.07.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DORËZIM-PRIMLJENO-RECEIVED			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Untt	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	052	30756	8

Suharekë 2026

I. HYRJE DHE BAZA LIGJORE

Ky raport i përgjithshëm përmbledh dhe pasqyron aktivitetet, veprimtarinë operacionale, menaxheriale dhe financiare të Ndërmarrjes Publike Lokale "EKO-THERANDA" për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025.

Raporti është përgatitur në pajtim me:

- Nenin 19, pika 3, nën-pika 9 të Statutit të NPL EKO-THERANDA;
- Nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 03/L-087.

Ky dokument shërben për informim dhe shqyrtim nga Bordi i Drejtorëve, Komuna e Suharekës si aksionar i vetëm, si dhe për transparencë ndaj publikut.

2. STRUKTURA E RAPORTIMIT

Periudha raportuese përfshin tri faza kryesore:

1. Faza Përgatitore (01.01.2025 – 31.05.2025)
2. Faza Operacionale Fillestare (01.06.2025 – 30.09.2025)
3. Faza Operacionale e Vazhduar (01.10.2025 – 31.12.2025)

3. FAZA PËRGATITORE (01.01.2025 – 31.05.2025)

3.1 Konsolidimi Institucional

Gjatë kësaj faze është zhvilluar një proces intensiv koordinimi me institucionet komunale dhe organet drejtuese të ndërmarrjes, me qëllim krijimin e bazës funksionale dhe ligjore për operim.

Janë realizuar takime me:

- Kryetarin e Komunës së Suharekës;
- Komisionin Aksionar;
- Bordin e Drejtorëve;
- Zyrtarin Kryesor Financiar të Komunës.
- Zyrtarin ligjor të Komunes

Këto takime kanë pasur për qëllim sigurimin e mbështetjes institucionale, rregullimin e çështjeve administrative dhe financiare, si dhe harmonizimin e veprimeve për funksionalizimin e NPL-së.

3.2 Infrastrukturë, Logjistikë dhe Dokumentacion

- Janë identifikuar dhe siguruar pajisjet bazike për funksionimin e zyrave;
- Janë inicuar dhe realizuar ndryshimet në certifikatën e biznesit pranë ARBK-së;
- Janë kryer përditësimet përkatëse në Regjistrin e Bizneseve Komunale të Kosovës;
- Janë hartuar draft-marrëveshje dhe rregullore bazë (Rregullorja për Pagat dhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm).

3.3 Bashkëpunime Ndërinstitucionale

Janë vendosur bashkëpunime me NPL-të tjera (Higjiena, Banesore, Kastrioti) si dhe me KRM EKO-REGJIONI, duke siguruar mbështetje teknike, pajisje dhe asistencë profesionale për fazën operacionale.

4. FAZA OPERACIONALE FILLESTARE

(01.06.2025 – 30.09.2025)

4.1 Fillimi i Shërbimeve Publike

Me datë 01.06.2025, NPL EKO-THERANDA ka filluar zyrtarisht ofrimin e shërbimeve në terren, bazuar në Kontratën nr.15/2025 e lidhur me Komunën e Suharekës më 29.05.2025.

Shërbimet kanë përfshirë:

- Pastrim dhe mirëmbajtje të përditshme të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike;
- Mirëmbajtje të objekteve publike dhe hapësirave të gjelbra;
- Aksione të posaçme pastrimi në zona urbane dhe rurale;
- Larje të rrugëve dhe eliminim të mbeturinave të ngurta.

4.2 Menaxhimi i Resurseve

- Aktivizimi i pajisjeve të huazuara nga Eko-Regjioni dhe NPL-të tjera;
- Organizimi i stafit sipas zonave të shërbimit;
- Monitorimi i përditshëm i punëve përmes raporteve të kryepunëtorëve.

4.3 Administratë dhe Transparencë

- Mbledhje të rregullta të Bordit të Drejtorëve;
- Evidentim i shpenzimeve, asetëve dhe faturave;
- Publikim i rregullt i aktiviteteve dhe dokumenteve në kanalet zyrtare;
- Komunikim i drejtpërdrejtë me qytetarët.

5. FAZA OPERACIONALE E VAZHDUAR

(01.10.2025 – 31.12.2025)

Gjatë kësaj periudhe është siguruar vazhdimësi e plotë e shërbimeve publike me theks në stabilitet operacional dhe rritje të cilësisë.

Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

- Pastrim dhe mirëmbajtje në të gjithë territorin e komunës;
- Mirëmbajtje të hapësirave të gjelbra dhe parqeve;
- Reagime të shpejta pas kushteve atmosferike;
- Eliminim të deponive ilegale;
- Menaxhim efikas të stafit dhe pajisjeve.

6. MENAXHIMI FINANCIAR

Gjatë gjithë periudhës 01.04.2025 – 31.12.2025:

- Nuk janë realizuar shpenzime reprezentative, shpenzime për derivate apo transport nga Kryeshefi Ekzekutiv;
- Është zbatuar disiplinë e lartë financiare;
- Janë realizuar të hyra nga ofrimi i shërbimeve, me shpenzime minimale;
- Është garantuar transparencë dhe përdorim racional i mjeteve publike.

7. PËRFUNDIM

Periudha 01.04.2025 – 31.12.2025 paraqet një fazë kyçe për NPL EKO-THERANDA, e karakterizuar nga:

- Konsolidim institucional dhe ligjor;
- Fillim dhe stabilizim të shërbimeve publike;
- Menaxhim të përgjegjshëm financiar;
- Rritje të besimit të qytetarëve;
- Funksionalitet të plotë operacional.

NPL EKO-THERANDA ka dëshmuar përkushtim të vazhdueshëm në realizimin e misionit të saj për një mjedis më të pastër, më të sigurt dhe më të mirëmbajtur për qytetarët e Komunës së Suharekës.

Raporti Financiar për periudhën: 01.04.2025-31.12.2025

Të HYRAT			
Nr.r	Datë:	Pershkrimi	Hyrje
1	14.02.2025	Pagesa sipas kërkeses për mbulimin e pagave të NPL EKO-THERANDA dhe funksionalizimin e NPL-së	20,000.00
2	20.06.2025	Pagesa për shërbimet e kryera sipas Kontratës në Shtëpi nga Komuna Suharekë-Qershor 2025	15,200.62
3	22.07.2025	Pagesa për shërbimet e kryera sipas Kontratës në Shtëpi nga Komuna Suharekë-Korrik 2025	10,651.62
4	22.08.2025	Pagesa për shërbimet e kryera sipas Kontratës në Shtëpi nga Komuna Suharekë-Gusht 2025	17,564.25
5	24.09.2025	Pagesa për shërbimet e kryera sipas Kontratës në Shtëpi nga Komuna Suharekë-Shtator 2025	17,859.15
6	29.10.2025	Pagesa për shërbimet e kryera sipas Kontratës në Shtëpi nga Komuna Suharekë-Korrik 2025 (borgji i mbetur i Fatures së korrikut)	6,932.82
7	29.10.2025	Pagesa për shërbimet e kryera sipas Kontratës në Shtëpi nga Komuna Suharekë-Tetor 2025	16,154.97
8	05.12.2025	Pagesa për shërbimet e kryera sipas Kontratës në Shtëpi nga Komuna Suharekë-Nentor 2025	18,297.97
9	26.12.2025	Pagesa për shërbimet e kryera sipas Kontratës në Shtëpi nga Komuna Suharekë-Dhjetor 2025	15,323.47
Totali i të Hyrave për periudhën 01.04.2025-31.12.2025			137,984.87

SHPENZIMET-DALJET			
Nr.r	Pershkrimi i shpenzimit	Dalje	Shpenzimet ne %
1	Furnizim me Derivate	1,394.01	1.15
2	Furnizim me material per mirembajtje te rrugeve	545.75	0.45
3	Mirembajtjedhe Komision bankes	70.45	0.06
4	Paga për punëtorë dhe komplet stafin	89,671.36	74.19
5	Reprezentacion	188.40	0.16
6	Material shkresor	103.65	0.09
7	Tatime dhe kontribute	27,328.23	22.61
8	Veshmbathje-Këpucë	448.50	0.37
9	Pagesa e Sigurimit, Regjistrimit dhe pjese Automjeteve	1,111.80	0.92
TOTALI I SHPENZIMEVE 01.04.2025-31.12.2025		120,862.15	100.00

Saldo me datë: 31.12.2025	17,122.72
Fatura te pa paguara per vitin 2025	615.70

*Obligimet që bartën nga Viti 2025 në vitin 2026 e të cilat konform afateve ligjore duhet të paguhen pasi të përfundojë periudha fiskale, janë obligimet që kanë të bëjnë me tatimet (TVSH, TAP dhe Tatimi në fitim) dhe kontributet pensionale.

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive:



Nga paraqitja grafike e shpenzimeve për periudhën **01.01.2025 – 31.12.2025**, vërehet se **paga për punëtorë dhe komplet stafin** përbën kategorinë dominuese të shpenzimeve, me **74.19%** të totalit, duke reflektuar qartë se pjesa më e madhe e buxhetit të Ndërmarrjes Publike Lokale “EKO-THERANDA” është e orientuar drejt **burimeve njerëzore** dhe ofrimit të shërbimeve direkte në terren.

Në vendin e dytë renditen **tatimet dhe kontributet**, të cilat përbëjnë **22.61%** të shpenzimeve totale, çka dëshmon një nivel të lartë të përmbushjes së **detyrimeve ligjore dhe fiskale**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërkohë, kategoritë e tjera të shpenzimeve, si:

- furnizimi me derivate (**1.15%**),
- furnizimi me materiale për mirëmbajtje të rrugëve (**0.45%**),
- veshmbathje dhe këpucë (**0.37%**),
- pagesa e sigurimit, regjistrimit dhe pjesëve të automjeteve (**0.92%**),
- reprezentacioni (**0.16%**),
- materialet shkresore (**0.09%**),
- mirëmbajtja dhe komisionet bankare (**0.06%**),

kanë një **peshtë shumë të vogël individuale**, duke u luhatur nga **0.06% deri në 1.15%**, dhe së bashku përbëjnë një pjesë minimale të totalit të shpenzimeve.

Në tërësi, përmes paraqitjes grafike dhe analizës strukturore të shpenzimeve, evidentohet një **strukturë e përqendruar e buxhetit**, ku mbi **96% e shpenzimeve** janë të dedikuara për **paga, tatime dhe kontribute**, ndërsa shpenzimet operative dhe administrative mbesin në nivel të ulët. Kjo strukturë reflekton një **menaxhim të kujdesshëm, racional dhe të kontrolluar të kostove operative**, duke garantuar stabilitet financiar dhe përdorim efikas të mjeteve publike.



Kryesues i Komisionit
komunal i aksionarëve

Mr.ec Bexhet KUÇI